



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____, 2018

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË TË DREJTËSISË
(Mbajtur, më 12.06.2018)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i kërkesës së ministrit të Drejtësisë për procedimin disiplinor të gjyqtarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, Ahmet Jangulli (masa disiplinore e propozuar “**shkarkim nga detyra**”).

Drejton mbledhjen Presidenti i Republikës së Shqipërisë si dhe Kryetar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Zoti Ilir Meta.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve e Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Filloi në orën 18:45 dhe mbaroi në orën 20:03.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|-----------------------------|------------------|
| 1. Ilir Meta | (kryetar) |
| 2. Etilda Gjonaj | (anëtare) |
| 3. Xhezair Zaganjori | (anëtar) |
| 4. Gjini Gjoni | (anëtar) |
| 5. Vangjel Kosta | (anëtar) |
| 6. Brunilda Kadi | (anëtare) |
| 7. Eneida Civici | (anëtare) |
| 8. Petrit Çomo | (anëtare) |

- | | |
|-------------------------------|-----------------|
| <i>9. Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>10. Astrit Haxhialushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>11. Gerd Hoxha</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>12. Neritan Cena</i> | <i>(anëtar)</i> |

Shënim 1: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, z. **Artan Broci**.

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Marsida Xhaferllari, Kryeinspektore pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.*
- 2. Pjerin Prendi, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.*
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit.*
- 4. Xhevdet Haxhiu, Drejtor në Drejtorinë e Administratës dhe Financës.*
- 5. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse në Sektorin e Organizimit të Mbledhjeve në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit.*
- 6. Elis Kuçi, Zëdhënës pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.*
- 7. Edlira Bako, Drejtore e Drejtorisë së Inspektimit Gjyqësor dhe Prokurorisë, përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 8. Besmir Beja, Këshilltar i Ministrisë së Drejtësisë.*
- 9. Alqi Bllako, Sekretar i Përgjithshëm i Presidentit.*
- 10. Bledar Dervishi, Këshilltar i Presidentit.*
- 11. Eksperte e Misionit EURALIUS.*
- 12. Ekspert i USAID-it.*

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i kërkesës së ministrit të Drejtësisë për procedimin disiplinor të gjyqtarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, Ahmet Jangulli (masa disiplinore e propozuar “shkarkim nga detyra”).

Ilir Meta: Atëherë, fillojmë, të mos humbasim më kohë, me rendin e ditës të cilin e dimë të gjithë.

Fillojmë me pikën e parë. Shqyrtimi i kërkesës së ministrit të Drejtësisë për procedimin disiplinor të gjyqtarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, Ahmet Jangulli. Po, të vijë shpejt ju lutem.

(Hyn në sallën e mbledhjes gjyqtari Ahmet Jangulli bashkë me avokatin e tij.)

Fillojmë atëherë?

Përpara se t'i japim mundësinë zotit Jangulli të paraqesë pretendimet e tij në mënyrë sa më koncize, zonja ministre do të thoshit diçka, apo...?

Po, zonja ministre!

Etilda Gjonaj: Atëherë, me shkresën e datës 21.02.2018, ministri i Drejtësisë i ka dërguar Këshillit të Lartë të Drejtësisë propozimin për marrjen e masës disiplinore “Shkarkim nga detyra” për gjyqtarin Ahmet Jangulli. Propozimi për marrjen e masës disiplinore ka ardhur në vijim të konstatimeve të dala nga hetimi disiplinor i kryer nga Inspektorati i KLD-së, i cili bazuar në urdhrin e verifikimit datë 04.03.2016 ka verifikuar ankesën e paraqitur nga Drejtoria e Policisë së Shtetit ndaj veprimtarisë së gjyqtarit Ahmet Jangulli të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër për zvarritje gjykimi në 5 çështje administrative.

Në përfundim të verifikimit të kryer, Inspektorati i KLD-së, me relacionin e datës 26.04.2017 ka konkluduar se gjyqtari Ahmet Jangulli ka shkelur në mënyrë të pajustificuar dhe të përsëritur, dispozitat urdhëruese procedurale, duke cenuar procesin e rregullt ligjor.

Me shkresën e datës 16.01.2018, Kryetari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë i ka përcjellë ministrit të Drejtësisë relacionin dhe dokumentacionin përkatës pasi ka vlerësuar se, sipas nenit 160, paragrafi i parë /c/, të ligjit 96/2016, një ndër kompetencat e KLD-së, në këtë periudhë tranzitore, është vendosja e masës disiplinore me propozim të ministrit të Drejtësisë. Sipas kësaj shkrese raportohet se shkeljet e mësipërme përbëjnë shkak për fillimin e procedimit disiplinor referuar nenit 140, pika 2, shkronja /a/ e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Gjithashtu, rezulton se nga të dhënat e grumbulluara gjatë këtij verifikimi, nga dokumentacioni që na është vënë, nga raporti që na është vënë në dispozicion nga Inspektorati i KLD-së, është çmuar se ankesa e Drejtorisë së Policisë së Shtetit për zvarritjen e gjykimit të çështjeve objekt kontrolli është e bazuar dhe e drejtë. Sipas raportit të inspektimit, inspektorati i KLD-së ka konstatuar se 5 rastet e inspektuara janë të zvarritura pasi kanë tejkaluar standardin kohor të përcaktuar në ligjin 49/2012 dhe sipas ligjit të mësipërm, në nenet 25, 26, 27, 28, 34, 42 janë caktuar afatet procedurale për kryerjen e veprimeve nga gjykata deri në dhënien e vendimit përfundimtar të arsyetuar. Duke mbledhur këto afate për çdo veprim procedural të gjykatës, kemi një afat përfundimtar prej 92 ditësh, i cili është edhe afati i arsyeshëm për përfundimin e gjykimit administrativ.

Për të gjetur shkaqet që kanë çuar në zvarritjen e gjykimit, Inspektorati i KLD-së ka analizuar veprimet procedurale të kryera nga gjykata, vërehet se gjyqtari, pasi ka marrë çështjen me short, ka caktuar seancën përgatitore. Pasi ka realizuar seancën e parë përgatitore, u ka lënë afat palëve për depozitimin e prapësimeve me shkrim, duke caktuar një seancë përgatitore, por në distancë kohore të konsiderueshme.

Në 5 çështjet objekt verifikimi, ka rezultuar se ky afat varjon nga minimumi 5 muaj e 8 ditë, në maksimumin 1 vit. Ky është shkaku kryesor që gjykimi tejkalon afatet e përcaktuara të gjykimit. Dhe duke mbajtur në konsideratë, ashtu siç përmenda pak më parë, bazën ligjore që është neni 140, paragrafi i parë i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku parashikohet se gjyqtari mban përgjegjësi disiplinore sipas ligjit dhe në vijim me nenin 140, paragrafi i 2/a i Kushtetutës, parashikohet se gjyqtarët shkarkohen nga KLGJ kur kryejnë shkelje të rënda profesionale ose etike që diskreditojnë pozitën dhe figurën e gjyqtarit gjatë ushtrimit të detyrës. Dhe sa më sipër, vlerësohet nga ana e ministrit të Drejtësisë, se gjyqtari Ahmet Jangulli duhet të mbajë përgjegjësi disiplinore sipas këtij neni.

Përfundimisht, bazuar në relacionin përcjellë edhe nga Inspektorati i KLD-së dhe nenit 140, paragrafi 2/a i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 160, paragrafi 1/c i ligjit 96/2016, ministri i Drejtësisë, i propozon këtij Këshilli vendosjen e masës

disiplinore “Shkarkim nga detyra” të gjyqtarit të Gjykatës së Shkallës së Parë Administrative Ahmet Jangulli.

Ilir Meta: Faleminderit!

Atëherë, zoti gjyqtar, në mënyrë koncize, cili është qëndrimi juaj?

Ahmet Jangulli: ...zoti Kryetar, President i Republikës!

Të nderuar anëtarë të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, zonja dhe zotërinj!

Ilir Meta: Jeni bashkë me avokatin?

Ahmet Jangulli: Po!

Ilir Meta: Juve si ju quajnë?

Avokati: Artan Meçe.

Ilir Meta: Faleminderit!

Ahmet Jangulli: Paraprakisht kisha trajtuar një kërkesë paraprake për të mos e lodhur seancën, për të mos e futur në vështirësi. Nëse doni, jua trajtoj. Nëse doni, fillojmë tek themeli, për çfarë u trajtua.

Në kërkesat paraprake kam trajtuar, i nderuar Kryetar... këto fjali janë të trajtuara me shkrim. Të gjitha janë 4 faqe e pak dhe telegrafisht po jua them krejt shkurtimisht me gojë.

Siç e dëgjuat edhe ministren, këtu bëhet fjalë për një propozim për masë disiplinore ndaj meje dhe po të jemi krejt të vëmendshëm, këtu nuk pati kërkesë për procedim, nuk pati procedim, nuk ka procedim të zhvilluar, ka vetëm thjesht propozim për shkarkim. Bëhet fjalë për një ankesë të datës 26.04... - më falni – për një ankesë që është regjistruar, protokoll 1420 protokoll, 23.04.2015, ankesë e cila nuk gjendet në material dhe ankesë e cila nuk dihet se ku është fati i saj.

Ka ardhur një informacion për 5 raste për llogari të tagrit të përfaqësimit dhe legjitimitit të përfaqësuesve në gjykim. Kjo është trajtuar si ankesë. Mban datën 06.01. Është protokolluar në numrin e protokollit të ankesës 23.04.2015, 1420 me fraksion. Kjo ankesë e pretenduar është arshivuar dhe nuk di se çfarë ka më andej. Kryesisht ka ndërhyrë Inspektorati dhe çfarë kemi kryesisht: Në materialin përkatës trajtohet me shkresën e relatimit 26.04.2017, pra është pritur të kalojnë 2 vjet nga ankesa dhe i kërkohet ministres, duke kërkuar mbi bazën e legjislacionit të shfuqizuar, që të iniciohet

procedim disiplinor ndaj gjyqtarit. Ky relativ 26.04.2017 përsëri është lënë në heshtje për 9 muaj dhe më 16.01.2018, nga KLD-ja, i dërgohet ministres përsëri për të kërkuar mundësinë e fillimit të procedimit disiplinor, duke trajtuar pra me normat e reja kushtetuese dhe ligjore dhe duke kërkuar sipas legjislacionit të vjetër. Pra deri këtu është krejt e qartë që nuk kemi fillim të procedimit disiplinor.

Në materialin, pra siç ju thashë, ka propozim dhe nuk ka proces të zhvilluar, pra unë nuk di se ka filluar procesi. Në materialin përkatës nisur nga shkresa e mësipërme, ministrja e Drejtësisë ka arritur në konkluzionin se, ka propozuar duke u bazuar në normat kushtetuese për shkarkimin e gjyqtarit, gjë e cila nuk është në tagrin e ministres, por ka përdorur normat duke trajtuar juridikisht fjalët e legjislacionit të vjetër.

Janë trajtuar si shkelje “shkelje të rënda profesionale që diskreditojnë rëndë figurën e gjyqtarit gjatë ushtrimit të detyrës” dhe ky juridiksion, pra këto fjalë, nuk gjenden në normën kushtetuese.

Për efekt të legjislacionit, pra kemi patur në fuqi ligjin 9877/2008, ligjin 8811/2001 dhe aktet nënligjore, Rregulloren e Inspektoratit të KLD-së dhe Rregulloren për procedim disiplinor. Sot nuk i kemi aktet nënligjore, kemi vetëm ligjin 8811/2001 dhe ligjin 96/2016.

I trajtoj këto në kuadrin e dy mundësive për KLD-në.

Së pari, se ka vend dhe mendoj që mos të shqyrtohet, pra të mbyllet procedimi për këto arsye: Hetimi disiplinor nga Inspektorati i KLD-së është kryer mbi bazën e legjislacionit të shfuqizuar, por nuk ka përfunduar brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit;

Procedimi disiplinor, duke e marrë si të tillë me ralionin e datës 26.04.2017 që është relatuar nga IKLD-së, nuk ka përfunduar, nuk është kryer brenda afatit 6-mujor dhe në këto rrethana, ky procedim, nuk mund të shqyrtohet mbi bazën e këtij ligji;

Materiali pranë ministrisë ka shkuar nga KLD-ja, nga Kryetari i saj, nëpërmjet mbulimit të punës së Zëvendëskryetarit, duke vlerësuar punën e Inspektoratit, në kundërshtim të hapur me ligjin 96/2016, i cili në asnjë germë të tij nuk thotë që materiali i kryer nga Inspektorati i KLD-së, i vihet në dispozicion ministres apo më tepër që

materiali hetimor i kryer nga Inspektorati, t'i vihet në dispozicion ministres nga KLD-ja. Në këto rrethana ky procedim nuk mund të shqyrtohet mbi bazën e këtij ligji;

Nga ministrja e Drejtësisë është propozuar një masë disiplinore nëpërmjet shkarkimit kushtetues për gjyqtarin, gjë e cila nuk është as kushtetuese dhe as ligjore. Në këto rrethana ky procedim nuk mund të shqyrtohet. Përgjegjësia disiplinore, sipas Kushtetutës, është vetëm sipas ligjit neni 140, pika 1 e Kushtetutës dhe në këtë drejtim nuk mund të ketë përgjegjësi disiplinore sipas Kushtetutës, duke zbatuar direkt normat kushtetuese për shkarkim kushtetues;

Ministrja e Drejtësisë ka të drejtën për të propozuar masë disiplinore vetëm mbi bazën e ligjit, ligj të cilin nuk e kemi për fatin e keq.. pasi Gjykata Kushtetuese ka shfuqizuar parashikimet ligjore mbi shkeljet disiplinore dhe në këto rrethana, ky procedim disiplinor nuk mund të shqyrtohet mbi bazën e këtij ligji. Shkarkimet janë të parashikuara në Kushtetutë dhe kemi dy shkarkime për gjyqtarin, njëri kushtetues për efekt normave kushtetuese dhe tjetri është për llogari të masave disiplinore mbi bazën e ligjit. Këtu është bërë një propozim nga ministrja, duke bërë një miks, duke i shkelur të dyja, qoftë Kushtetutën, qoftë edhe ligjin, duke përdorur normat kushtetuese dhe duke trajtuar ato mbi bazën e legjislacionit të vjetër;

Këshilli i Lartë i Drejtësisë nuk ka kompetencat kushtetuese që ka Këshilli i Lartë Gjyqësor, por ka vetëm kompetencat ligjore deri në krijimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor;

Këshilli i Lartë i Drejtësisë nuk mund të shqyrtojë propozimin e ministres për një masë disiplinore nëpërmjet shkarkimit kushtetues për gjyqtarin dhe në këto rrethana nuk mund të shqyrtohet ky procedim;

Këshilli i Lartë i Drejtësisë, në qoftë se e quajmë të tillë, nuk mund të çmojë mbi shkeljet disiplinore pa ligj, pa qenë të parashikuara në ligj shkeljet disiplinore, të cilin nuk e kemi pra se Gjykata Kushtetuese ka shfuqizuar parashikimet ligjore.

Së dyti, në varësi të vlerësimit të mësipërm, nëse nuk çmohet kërkimi që po paraqes për të vendosur mos shqyrtimin apo mbylljen e procedimit siç trajtohet me ligjin e ri, mendoj se ka vend Këshilli i Lartë i Drejtësisë të vlerësojë paraprakisht mbi pengesat ligjore, neni 30 e vijues i Kodit të Procedurave Administrative, për nenin 25 të ligjit 8811/2001 për shqyrtimin, pasi, sipas materialit nuk thuhet asnjë fjalë e vetme se kush e

ka filluar procedimin disiplinor ose më saktë nuk ka fillim të procedimit, për të gjykuar mbi pengesat ligjore;

Nga ministrja e Drejtësisë është propozuar një masë disiplinore, por mendoj se ministrja e Drejtësisë nuk duhet të mbajë mbi supë atë që s'e ka bërë, pra fillimin e procedimit disiplinor dhe në këto rrethana, për sa kohë ligjvënësi ka parashikuar se në rastin konkret, kur ministrja ka nisur procedimin disiplinor, nuk merr pjesë në votim, pyetja që shtrohet është se kush nuk do të marrë pjesë në votim për rastin, gjë e cila mendoj se është shumë e rëndësishme në proces;

Nëse do mendohet se Këshilli i Lartë i Drejtësisë do ta fillojë vetë apo e ka filluar vetë procedimin disiplinor, i takon që në logjikën e ligjit, ai që e fillon, nis procedimin disiplinor, nuk merr pjesë në votim, do të thotë se kthehemi aty ku ishim më lart, që ky procedim nuk mund të shqyrtohet mbi bazën e ligjit, për sa kohë nuk mund të votohet shqyrtimi.

I themi paraprakisht për të dhënë mundësinë këtij këshilli të nderuar që të kthehet brenda kornizave ligjore në punën e tij të nderuar.

Meqenëse i kemi kaluar, po trajtoj vetëm dy fjalë për efekt të rrethanave.

I kam sipas çështjeve të renditura dhe jo ashtu siç janë të renditura në material, as i pari dhe as i fundit s'e merr vesh kush është.

Çështjen e parë e kemi të tillë – Është e 2014 dhe ka përfunduar më 29.09.2015. Pra nga regjistrimi deri tek vendimi ka zgjatur 1 vit, 3 muaj, 16 ditë. Kjo çështje, ky proces akoma nuk ka përfunduar në Gjykatën e Apelit. Pra, në qoftë se për ne ka zgjatur 1 vit e 3 muaj, atje akoma s'ka filluar. Duke zbritur kohën gjatë të cilës çështja ka qëndruar në pritje të gjykimit – se këtu bëhet fjalë për kohën që presin çështjet për gjykim, dhe është një abuzim i pastër që bëhet ndaj meje sepse duke hequr këtë kohë, bëhet fjalë për çështjen e parë 2 muaj e 28 ditë gjithsej.

Çështja e dytë është në 2014 dhe ka përfunduar në 2015. Ka zgjatur në tërësi për 1 vit, 3 muaj e 16 ditë. Edhe kjo çështje është përfunduar në Gjykatën e Apelit por s'po e themi se si dhe çfarë sepse është më i gjatë se sa ky afat kohor që kemi këtu. Duke hequr kohën e pritjes, kemi 2 muaj e 5 ditë të gjykuar.

Çështja e tretë në 2015 dhe ka përfunduar në 2016 dhe afati tërësor është 1 vit e 18 ditë dhe duke zbritur atë çfarë thamë, ngelet për 7 muaj e 4 ditë. Ky 7 muajshi këtu, për korrektësi po jua themi, bëhet fjalë që ka pasur ekspertim teknik dhe ekspertimi jo vetëm që është kryer dhe ka pasur një çështje shumë voluminoze me 10 fashikuj por është bërë edhe shtesë ekspertimi. Thjesht po e themi.

Çështja tjetër është, bëhet fjalë, ka zgjatur gjithsej 8 muaj nga regjistrimi. Duke hequr kohën e pritjes, çështja ka mbaruar për 1 muaj e 25 ditë.

Çështja e fundit ka zgjatur 7 muaj e 13 ditë gjithsej. Duke hequr kohën e pritjes, është 1 muaj e 6 ditë.

Pra duke zbritur kohën gjatë të cilës çështjet e regjistruara kanë qëndruar në pritje të gjyqimit, çështjet e mësipërme janë gjykuar në kohë rekord dhe jo më të konsiderohen si gjykime të zvarritura. Çështjet e mësipërme janë çështje me palë kundërshtare dhe me problematikën e tyre që as nuk mund të konsiderohen si çështje administrative të pastra.

Me përfundimin e veprimeve përgatitore dhe daljen e urdhrin për seancë gjyqësore, gjykimi ka përfunduar me një seancë të vetme ose me dy seanca për llogari të bisedimeve dhe jo për llogari të vendimeve dhe vendimet e mia dorëzohen të nesërmen ose të pasnesërmen në sekretari, në të gjithë jetën e punës, jo vetëm për këto.

Për rastet e mësipërme, një çështje ka përfunduar me një seancë, tre me dy seanca dhe njëra ndoshta me disa seanca dhe seancat janë për 1 muaj e 22 ditë të gjitha - që trajtohet sikur çfarë është bërë atje.

Në të 5 rastet e mësipërme, vetë Inspektorati i KLD-së thotë në relacion që - gjyqtari, për atë çfarë është ankuar - ka konkluduar Inspektorati – më falni, se me shikimin nuk jemi mirë – pra ka konkluduar, vetë Inspektorati thotë për rastet që flasim që nuk ka as ankesë dhe është ankesë e arshivuar, pra ankesa e parë e 2015 nuk gjendet gjëkund. Kjo që trajtohet si ankesë, që nuk është ankesë por është bashkangjitur fizikisht, thuhet nga Inspektorati vetë, ka trajtuar se nuk është shtyrë seanca për këtë shkak dhe çështjet pastaj trajtohen të zvarritura. Se ku është zvarritja? Se si konceptohet nga Inspektorati, e dinë ata që e kanë bërë.

Duhet të citoj këtu, jo pa vend, jo për efekte mbrojtjeje, siç përdoret rëndom nga palët parapara rasteve të tilla, kjo është praktikë është përdorur kudo. Kjo praktikë

përdoret në gjykatën tonë. Unë sapo kam marrë një çështje që është e 2016, që e ka mbajtur kolegja për 2 vjet të tjera.

Për efekt themeli nuk kam tjetër gjë për të trajtuar, veçse ato që thashë më lart. Janë trajtuar me shkrim në oponencën që i kam bërë shkresës së trajtuar si kërkesë për procedim nga ana e KLD-së. Në fakt ajo nuk është kërkesë për procedim por është kërkesë për propozim, siç e tha vetë ministrja (këtu është prezent). Nëse duhet pra, unë i kam të gjitha me shkrim të trajtuara, qoftë në oponencën, qoftë në atë çfarë kam bërë më përpara, qoftë edhe këtu pra. Por s'dua ta bezdis seancën. Nuk ka ndonjë gjë avokati për të trajtuar.

Ilir Meta: Më fal! Ndoshta është më mirë të bëjmë pyetje sepse edhe anëtarët i kanë parasysh pretendimet edhe të ministrisë edhe tuajat.

Po, zoti Gjoni!

Gjin Gjoni: Faleminderit, zoti President!

Faleminderit, zoti Jangulli!

Unë kam ca pyetje në lidhje me procedimin disiplinor.

Pyetja e parë konsiston në faktin, nga kush është nisur procedimi disiplinor dhe nga kush ka ardhur shkresa për fillimin e procedimit disiplinor?

Ahmet Jangulli: I nderuar zoti Gjoni, të falenderoj shumë për mundësinë që më jep. Pra këtu nuk ka shkresë për fillim të procedimit disiplinor. Pra në material, nëse gjendet ndonjë shkresë që ka filluar dikush procedimin disiplinor, le ta nxjerrë sot. Nuk ka rëndësi, e marrë edhe sot. Pra nuk ka proces të zhvilluar dhe jua them me përgjegjësi të plotë dhe me ndershmëri të pastër. Këtu ka vetëm propozim abuzues duke abuzuar me të drejtën.

Gjin Gjoni: Pyetja e dytë: Mbi ç'bazë është filluar procedimi, mbi bazën e një ankese apo mbi bazën kryesisht nga ana e Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë?

Ahmet Jangulli: Po!

Ankesa është 23.04.2005. 2015, më fal.

Gjin Gjoni: Për çështje konkrete apo në përgjegjësi për të gjitha çështjet.

Ahmet Jangulli: Edhe një herë, të lutem. Të falenderoj shumë.

Pra, ankesa është regjistruar...

Gjin Gjoni: S'ke nevojë të më falënderosh ti.

Ahmet Jangulli: Të falenderoj se më jep mundësi për të thënë fjalën.

Pra 23.04.2015 është ankesa por nuk është kjo ankesë. Është e arshivuar dhe s'dihet ku është fati i saj. Është informacion që dërgohet për efekt të përfaqësimit në gjyq dhe legjitimitetit të përfaqësuesve në gjyq. Është bashkuar fizikisht kësaj, që s'dihet se ku është dhe ky informacion është arshivuar.

Thuhet që nuk ka asnjë shkelje të trajtuar për efekte përfaqësimi dhe legjitimitetit të përfaqësuesve në gjyq.

Gjin Gjoni: Pyetja e tretë: Juve, mbi bazën e shortit të organizuar, a jeni zgjedhur anëtar i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi?

Ahmet Jangulli: Po! Jam zgjedhur. Ashtu e di, se jam zgjedhur. Kemi bërë një seancë mbledhje.

Gjin Gjoni: Dhe pyetja e katërt që ka të bëjë: Juve jeni në radhën e parë të procesit të vetingut për shkak të pozicionit si anëtar i KED-së?

Ahmet Jangulli: Po, jam.

Gjin Gjoni: Ju është mbledhur dokumentacioni në lidhje me këtë çështje?

Ahmet Jangulli: Po, është mbledhur dokumentacioni dhe ka vazhduar gjithçka puna. Ndoshta pritet nga dita në ditë që të vijë data.

Gjin Gjoni: Faleminderit, zoti President!

Nuk kam pyetje tjetër.

Ilir Meta: Po, faleminderit!

Po, zoti Çomo!

Petrit Çomo: Unë desha të pyes, këto çështjet për të cilat ju kanë sjellë për zvarritje, si kanë përfunduar? Është pranuar padia apo është rrëzuar?

Ahmet Jangulli: Edhe një herë, ja t'i them sepse janë pesë. I kam të shkruara por nuk e çova piacën deri aty.

E para është kthim padie. E dyta është mos pranim kërkesë. E treta është pranim kërkesë, lënie në fuqi në apel, njësoj siç është vendos në shkallë të parë. E katra rrëzim kërkesë padie, s'është ankuar nga askush rrëzimi. Dhe e pesta është pushim gjykimi. Edhe për këtë s'besoj se është ankuar nga askush.

Petrit Çomo: I bëra këto pyetje se është ankuar i padituri apo jo?

Ahmet Jangulli: I padituri s'është ankuar.

Ata që merren me ankesën janë... *(Pa mikrofon.)*

Petrit Çomo: E dyta pyetje është: Sa çështje gjykon në vit ti mesatarisht?

Ahmet Jangulli: ...Këtu bëhet fjalë për çështje të themelit, 620 a 630, sa është thënë, dhe mbi 6-7-fishin e këtyre, kemi kërkesa të tjera që marrin formë të prerë brenda vitit.

Petrit Çomo: Edhe e fundit që kam.

Ka çështje të tjera tek gjykata juaj që kalojnë 1 vit nga dita e regjistrimit?

Ahmet Jangulli: Të gjitha.

Brunilda Kadi: Nga materiali shprehet... te ankuesi është pretenduar nga policia që juve nuk keni njohur përfaqësuesin sepse i keni konstatuar me probleme aktin e përfaqësimit. Ndërkohë, nga ana juaj i është dhënë mundësi palës që të rregullojë aktin e përfaqësimit sipas nenit 176 apo...? Sepse nuk ishte shumë e qartë në relacion.

Ahmet Jangulli: Faleminderit!

Faleminderit, e nderuar!

Pra këtu bëhet fjalë për ankesën që ka bërë Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, pra ish Drejtoria e Policisë në atë kohë kur e ka bërë kërkesën, dhe ankesa bëhet fjalë për çështje që janë të përfunduara. Këtë mos ta harrojmë. Pra bëhet fjalë për katër çështje që kanë qenë të përfunduara, kur ka ardhur informacioni. Se nuk ka ardhur ankesë, por bëhet fjalë për informacion. Pra kanë qenë të përfunduara. Dhe ka qenë në gjyq vetëm një nga çështjet. Sepsi është ajo çështje për të cilën gjykata ka pranuar dhe e ka lënë në fuqi apeli. Aty bëhet fjalë që, drejtori vendor i jep tagër punonjësit të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Pra nuk ka asnjë rregull për ata për të thënë të vijnë në gjykatë, të hyjnë aty dhe është në rregull gjithçka. Dhe çfarë kërkuat ju, do dalë tek përgjigja. Ata nuk janë ankuar për këtë punë, asgjëkundi.

(Disa nga anëtarët flasin njëherësh pa ndezur mikrofonat.)

Pa diskutim që të gjitha mundësitë janë...

Pa diskutim e nderuar. As që bëhet fjalë për atë.

Neritan Cena: Zoti Jangulli, organika në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër është e plotë?

Ahmet Jangulli: Jo, organika s'ka qenë e plotë që nga krijimi. Pra ndonëse ligjvënësi ka vendosur 4 gjyqtarë, ne jemi 2 gjyqtarë nga fillimi. Nëse është e mundur, do e parashtroja krejt me dashamirësi, që të paktën pagën e dy të tjerëve të na e jepni neve, do ishte mirë. Se na doli shpirti. Sepse ne e kemi bërë punën në fakt.

Ilir Meta: Falenderojmë zotin Jangulli për sqarimet që dha edhe pyetjet që u bënë. E përfundojmë këtë seancë. Faleminderit atëherë!

(Gjyqtari Ahmet Jangulli dhe avokati i tij largohen nga salla e mbledhjes.)

Ilir Meta: Po, fjalën e ka ministrja!

Etilda Gjonaj: Është shumë e qartë mënyra se si ka filluar procedura e inspektimit për gjyqtarin. Inspektorati i KLD-së, bazuar në urdhër-verifikimin 1420 datë 04.03.2016 ka verifikuar ankesën e paraqitur nga Drejtoria e Policisë së Shtetit ndaj veprimtarisë së gjyqtarit Ahmet Jangulli për zvarritje gjykimi në 5 çështje civile. Në përfundim të verifikimit të kryer, Inspektorati i KLD-së, me relacion datë 26.04.2017 i ka relatuar Kryetarit të KLD-së rezultatet e verifikimit, ku është konkluduar se ky gjyqtar ka shkelur në mënyrë të pajustificuar dhe të përsëritur dispozitat urdhëruese procedurale, duke cenuar procesin e rregullt ligjor. Relacioni është miratuar nga Kryetari i KLD-së, i ka kaluar ministrit të Drejtësisë në datën 16.01.2018 dhe ministri i Drejtësisë, menjëherë, një muaj më pas, ashtu siç relatova në materialin më parë, 21.02.2018, i ka dërguar Këshillit të Lartë të Drejtësisë propozim për marrjen e masës disiplinore në bazë të këtyre shkeljeve të evidentuar në raportin e inspektimit të Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Kështu që, mua nuk më duket ndonjë habi në pjesën e procedurës së ndjekur për pjesën e inspektimit nga Inspektorati apo edhe kompetenca tashmë shumë herë të diskutuara të ministrit të Drejtësisë për të propozuar masën disiplinore ndaj gjyqtarit dhe bazën ligjore (neni 140 i Kushtetutës), për llojin e masës së propozuar.

Ilir Meta: Zoti Gjoni!

Gjin Gjoni: Faleminderit, zoti President!

Faleminderit, zonja ministre!

Unë diskutimin tim do e nis nga neni 172 i legjislacionit, i ligjit “Për statusin e gjyqtarëve”. Në rast se do i referohesh dispozitave kalimtare për procedimet dhe e bëj këtë diskutim meqenëse radhën e kaluar unë nuk fola dhe një radhë përpara kërkova që të bëj një diskutim në parim. Këtu ndajmë disa koncepte të cilat kanë të bëjnë në lidhje me të drejtën dhe në rast se do i referohemi të drejtës, do fillojmë nga Kushtetuta, pastaj edhe nga ligjet të cilat aktualisht janë në fuqi.

Hetimet disiplinore të papërfunduara, -thotë neni 172 “Dispozitat kalimtare” për procedimet disiplinore, -në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, nga Ministria e Drejtësisë, Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe inspektorët në zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm, përfundon tre muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji, sipas dispozitave në fuqi, para hyrjes në fuqi të këtij ligji. Procedimet disiplinore të papërfunduara në Këshillin e Lartë të Drejtësisë ose në Prokurorinë e Përgjithshme, në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji, kryhen brenda 6-mujorit pas hyrjes në fuqi të këtij ligji. Organet kompetente sipas nenit 160 të këtij ligji, zbatojnë rregullat procedurale të parashikuara në këtë ligj.

Në rast se i referohemi nenit 160, mbi të cilën pretendohet që ka filluar edhe procedimi disiplinor dhe është sjellë sot përpara nesh, ku përsëri është dispozitat kalimtare, organet kompetente në periudhën kalimtare, aty është e përcaktuar në mënyrë taksative “Vendos masat disiplinore me propozim të ministrit bazuar në procedurën dhe kriteret e parashikuara në pjesën 5”.

Çfarë thotë pjesa 5? Dhe hajde të shkojmë tek Kreu 5 – “Pezullimi i detyruar; Pezullimi mbi bazë diskrecioni; Fillimi i procedimit të pezullimit; Njoftimet për Këshill; Vendimet e pezullimit dhe ankimet; Kufijtë e kohëzgjatjes së pezullimit; Pezullimi i pagës dhe përfitimet e tjera”. Këtë thotë ligji.

Në cilën prej këtyre dispozitave, parashikuar neni 160, pika /c/, ministrja e Drejtësisë ka të drejtë që të vijë përpara nesh me këtë propozim?

Këtë propozim, po t’i referohesh dispozitave kalimtare, mund ta bënte Kryeinspektorja e Këshillit të Lartë të Drejtësisë derisa të krijohet Inspektorati i Lartë i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ta lexonte. Dhe ne kemi qenë me tre ministra paraardhës, me zotin Manjani, me zotin Vasili dhe me zotin Bardhi, të cilët nga shkurti i 2016, që ka qenë afati përfundimtar i procedimeve disiplinore, të cilët kanë qenë në procedim por që

ishite afati 3-mujor, këta zotërinjtë nuk propozonin më as edhe një masë disiplinore dhe propozimi bëhej nga anëtarët e Këshillit mbi bazën... dhe ministri i Drejtësisë merrte pjesë në votim njësoj me të gjithë anëtarët e Këshillit. Në qoftë se unë jam gabim, hajde hapim procesverbalet e mbledhjes. Janë të gjitha të regjistruara. Janë të gjitha të shënuara. Nuk e di nga na doli kjo procedurë e re?!

Pse doli kjo procedurë? – Sepse ministrja e Drejtësisë duhet patjetër që të marrë pjesë në votim njësoj si të gjithë anëtarët e KLD-së dhe nuk mund të vijë me një propozim sepse kjo kompetencë i ka ikur që në shkurt të 2016, dhe këtë e thotë ligji, nuk e them unë. Dhe ministrja e Drejtësisë të vijë me kuorumin e nevojshëm dhe të krijojë, në rast se anëtarët e Këshillit nuk janë kundër shkarkimit, le të bëhet kuorumi, në kuptimin e mirë të fjalës, dhe të mos humbi për 1 votë.

Aspekti i dytë, hajde shkojmë tek Kushtetuta. Kushtetuta e ka thënë në mënyrë taksative, në qoftë se do i referohemi Kushtetutës. Kush janë dy momentet për të cilët mund të shkarkohet gjyqtari? Dhe ka thënë, vendim i formës së prerë... më fal, fillim i procedimit, vendim i formës së prerë është penal dhe raste të tjera të cilat i ka parashikuar. Në rastin konkret, Gjykata Kushtetuese, ne e kemi deklaruar, i ka shfuqizuar dispozitat, i ka shfuqizuar kriteret mbi të cilat merren masat disiplinore dhe asnjë nga masat e tjera, ne nuk mund t'i shqyrtojmë. Vendimi nr. 34 i Gjykatës Kushtetuese e ka dhënë në mënyrë taksative. Kështu që, në rast se do i qëndrojmë këtij momenti, hajde t'i qëndrojmë.

Aspekti i tretë dhe është shumë i rëndësishëm, zotëria në fjalë për dy javë del përpara vetingut dhe ky zotëri mund të futet në sitën e vetingut dhe mund të qëndrojë si njeri i cili është i pastër ose jo i pastër sepse për shkak të procedurës e cila po ndiqet, sot zotëria është i zgjedhur me short anëtar i KED-së dhe përparësi, sipas njoftimeve (se unë s'kam as ndonjë informacion por të paktën të shtypit) do jepet, anëtarëve të cilët zgjidhen për KLGJ-në, KLP-në dhe KED-në. Tani, këtu, në qoftë se kemi ardhur për të bërë shou (show) dhe për të dalë në deklarata për shtyp dhe për të thënë që KLD-ja është armiku i popullit, KLD-ja është që po i prish imazhin. Në qoftë se KLD-ja do ishte e mirë, nuk do kishim këtë ligj që kemi sot. Se kërkuat për ta shkruar KLD-në, pavarësisht se nuk kemi, unë të paktën, minimalisht, nuk kam ndonjë qejf që të jem anëtar i KLD-së, s'kam asnjë

lloj përfitimi në mënyrën më absolute dhe s'kam pas, vetëm kam marrë kosto deri në momentin aktual, për shkak të qenies anëtar i KLD-së dhe kam mbrojtur gjyqtarët, patjetër që i kam mbrojtur dhe i kam mbrojtur me bindje, në pjesën më të madhe, por kjo është çështje votimi. Këtu, në këtë moment, asnjë nga forcat politike nuk mund të fitojë vota duke sharë KLD-në. Se KLD-ja ka marrë fund. KLD-ja është thjesht në një dispozitë tranzitore. Për sa kohë që jemi në dispozita tranzitore, unë jam i detyruar që të shpjegoj ligjin dhe të votoj në përputhje me legjisllacionin, me Kushtetutën, me neni 160 dhe me nenin 172. Faleminderit, zoti President!

Ilir Meta: Dakord!

Atëherë, unë mendoj të mos hyjmë nëpër debate teorike-parimore. Lemë ndonjë ditë tjetër që ta fillojmë në mëngjes dhe të mbarojmë vonë, meqë jemi në një orë të vonë dhe kemi edhe angazhime të tjera. Kështu që unë mendoj secili të shprehet me votë.

Po, zonja ministre, po!

Etilda Gjonaj: Faleminderit, zoti President!

Në radhë të parë, lidhur me referimin e nenit 172, pika 2, thuhet që procedimet disiplinore të papërfunduara në Këshillin e Lartë të Drejtësisë ose në Prokurorinë e Përgjithshme, në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji, kryhen brenda afatit 6-mujor, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji. Dhe organet përgjegjëse, sipas nenit 160 të këtij ligji, zbatohen rregullat procedurale të parashikuara në këtë ligj. Fakti që KLD-ja nuk ka marrë vendim, nuk ka shqyrtuar raportin e Inspektoratit, pra të një hetimi të papërfunduar ose që ka qenë i papërfunduar në momentin që ky ligj ka hyrë në fuqi, kjo nuk do të thotë që ne duhet ta lemë pa shqyrtuar. Dhe është një çështje dhe një diskutim që ne e kemi bërë gati pesë mbledhje me radhë, ku ministri i Drejtësisë ka propozuar masat disiplinore për gjyqtarë të ndryshëm, dhe nuk e kuptoj këtë ndryshim kursi i cili jo vetëm që çbën çfarë vendimesh dhe çfarë interpretimi kemi bërë ne në bazë të ligjit dhe në zbatim vetëm të ligjit, duke iu risjellë mbrapsht një vendimmarrje të cilën ka apo s'ka krijuar pasoja, kjo është për shkak të vendimmarrjes së KLD-së. Lidhur me nenin 160, e thotë shumë qartë, 160/1/c thotë: -“Vendos masat disiplinore me propozim të ministrit të Drejtësisë bazuar në procedurën dhe kriteret që parashikohen në pjesën 5 Kreu 1 të këtij ligji”, pra ia njeh të gjithë të drejtën ministrit të Drejtësisë të bëjë propozime për masat disiplinore në bazë

të raportit të Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Dhe për sa i përket pjesës 5, Kreu 1 të këtij ligji, zoti Gjoni iu referua në mënyrë të gabuar, se në fakt, pjesa 5, Kreu 1 i ligjit flet për përgjegjësinë disiplinore civile dhe penale dhe ne e kemi interpretuar shumë herët edhe në mbledhje të mëparshme, ku kemi thënë që, për sa kohë që Gjykata Kushtetuese ka shfuqizuar këtë pjesë të shkeljeve disiplinore, atëherë ne i referohemi nenit 140 të Kushtetutës dhe kjo është një gjë që është thënë dhe është në zbatim dhe në interpretimin më të drejtë të ligjit.

Kështu që, ministri i Drejtësisë ka të drejtë të bëjë propozimet për masat disiplinore në bazë të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve” dhe Kushtetutës, neni 140, paragrafi i dytë.

Gjin Gjoni: Vetëm diçka zoti President.

S’kam ndryshuar qëndrim, por do them vetëm diçka.

Më fal, zoti President, që marrë fjalën për herë të dytë.

Unë i lexova të dy dispozitat dhe normalisht, secili prej nesh është jurist dhe të paktën i kupton dispozitat ligjore. Unë nuk mendoj dhe e them, e përsëris, që ky Këshill i Lartë i Drejtësisë ka ndryshuar qëndrim në lidhje me tre ministrat paraardhës, dhe e njëjta procedurë që po kërkoj unë, është zbatuar nga tre ministrat paraardhës. E vetmja procedurë që na ndryshoi është me ministren aktuale. Në rast se ka ndonjë ndryshim dhe kjo KLD e lexon herë ligjin kur ishte zoti Vasili ministër dhe herë ligjin ndryshe kur është zonja Gjonaj këtu në KLD, kjo është çështje konceptimi pastaj. Por KLD-ja ka marrë ca qëndrime.

Sa i përket, në lidhje me KLD-në, prandaj kjo KLD ndoshta ka qenë një çikë e ngurtë dhe më vjen keq që sot Gjykata e Lartë nuk është në funksion, por duhet të them që, kjo KLD ka hequr nja 10-15 gjyqtarë gjatë periudhës që ka qenë. Të gjithë gjyqtarët sot i ke në detyrë për shkak të vendimeve të KLD-së, për shkak të këtyre procedurave. Sepse ana procedurale është elementi bazë, e cila çon në arritjen e konkluzionit përpara gjykatave më të larta. Dhe gjykatat më të larta na i kanë kthyer çështjet, bile ka çështje që na i kanë kthyer edhe dy herë që kemi shkarkuar të njëjtin gjyqtar dhe ka dhënë qëndrime.

A duhet t'i zbatohet këto vendime të gjykatave? – Unë them që po! Sepse Kushtetuta e thotë në mënyrë taksative, neni 136 i Kushtetutës e thotë “vendimet gjyqësore janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga të gjitha organet shtetërore”.

Ilir Meta: Dakord!

Po!

Etilda Gjonaj: Duhet, njëkohësisht, si të zbatohet vendimet e gjykatës, të zbatohet edhe vendimin 34 të Gjykatës Kushtetuese të vitit 2017, që ka të bëjë me interpretimin vazhdues të kompetencave të KLD-së për vendimmarrjen sipas kompetencave të nenit 160 “Dispozitat tranzitore”.

Një sekondë, ta mbaroj.

Ne kemi më shumë se 5 seanca që diskutojmë dhe marrim vendime në bazë të propozimeve të ministrit të Drejtësisë me këtë bazë ligjore. Nuk e kuptoj cili është ndryshimi kaq i madh nga ju zoti Gjoni që pas 5 seancave që ne kemi kryer – jo, nuk keni pasur këtë qëndrim – pas 5 seancave që kemi kryer, rezulton që nuk paska kompetencë ministri i Drejtësisë, kur është shprehur qartësisht, si tek neni 172, si tek 160-ta, si tek kreu që ju përmendët, Kreu 5 që e referon neni 160, që ministri i Drejtësisë propozon në bazë të raportit të Inspektoratit dhe nuk ka asnjë edhe një lloj lidhje fakti që gjyqtari përkatës është pjesë apo do të kalojë procesin e vetingut pas 2 javësh apo pas 3 javësh. Këshilli i Lartë i Drejtësisë duhet të kryejë kompetencat e tij, detyrat e tij, ashtu si edhe duhet të vijë në mbledhje kur lihet për t'u bërë mbledhja, ashtu si edhe për të bërë deklaratat secili nga ne e ka të gjithë të drejtën, edhe kur dilni ju jashtë kësaj sale, ashtu siç kur dal unë.

Gjin Gjoni: Vetëm sa i përket vendimit të Gjykatës Kushtetuese.

Në rast se do i referohemi vendimit të Gjykatës Kushtetuese, hajde ta zbatohet motamo vendimin e Gjykatës Kushtetuese dhe vendimi i Gjykatës Kushtetuese, në qoftë se thotë që marrin të gjitha kompetencat, hajde bëjmë edhe emërimet e gjyqtarëve sot dhe të marrim kompetencat që ka Këshilli. Por jo ato kompetenca që doni juve t'i marrim dhe ato kompetenca që t'i jep vendimi mos t'i marrim. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese duhet interpretuar ashtu siç e ka shkruar Gjykata Kushtetuese.

Etilda Gjonaj: Kompetenca i keni shumë të qarta, neni 160, ligji “Për statusin e gjyqtarit dhe prokurorit”.

Ilir Meta: Ju lutem, mos të përsërisim të njëjtin qëndrim të gjithë së bashku.

Atëherë, ju i qëndroni të njëjtit propozim për shkarkim për gjyqtarin Jangulli?

Etilda Gjonaj: Po Kryetar, të njëjtit propozim, për shkarkimin e gjyqtarit.

Ilir Meta: Atëherë, kush është dakord me propozimin e ministret?

Ilir Meta: Po, unë jam dakord.

Zoti Zaganjori nuk voton se ka problem që çështja mund të shkojë atje.

(Disa nga anëtarët flasin njëherësh pa ndezur mikrofonat duke u shprehur se çështja nuk shkon atje.)

Po, Zoti Zaganjori!

Xhezair Zaganjori: Nuk bëra as pyetje, nuk u përfshiva sepse është hera e parë që marrë pjesë në një diskutimin e një mase disiplinore, ku diskutohet shkarkimi i një gjyqtari, sepse siç e dini, procedura është e tillë që subjekti ka të drejtën e ankimit, i cili më përpara vinte direkt në Gjykatën e Lartë dhe tani normalisht ndjek procedurën administrative, pra vjen sërish në Gjykatën e Lartë, kolegjin që unë drejtoj. Kjo ka qenë arsyeja që asnjëherë nuk kemi marrë pjesë në diskutimin e masave disiplinore për shkarkim. Ndërsa për masat e tjera disiplinore, po. Por edhe në këtë rast kryetari nuk ka marrë pjesë... në gjykimet në Gjykatën e Lartë.

Gjin Gjoni: Me shpjegimet e qëndrimit që dhashë në parashtrësë, unë jam kundër.

Vangjel Kosta: Pro.

Brunilda Kadi: Kundër, për të njëjtën arsye që kam thënë edhe në procedimet e tjera për pjesën procedurale, por në këtë rast edhe për pjesën e themelit sepse nuk mendoj që mund të shkarkohet një gjyqtar sepse ka zvarritur 5 çështje. Ai mund të ketë 100 kusure të tjera, por për kaq sa është sjellë, unë nuk mendoj që është rasti për shkarkim.

Eneida Civici: Kundër sepse nuk jemi në kushtet e nenit 140, pika 2 e Kushtetutës. Çmoj që nuk është cenuar rëndë, nuk janë shkelje të rënda profesionale ose etike që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit për sa kohë janë paraqitur vetëm 5 çështje të një viti kalendarik, të dy viteve kalendarike, ndërkohë që nuk është bërë një panoramë e plotë dhe e qartë se sa çështje ka gjykuar në këtë vit kalendarik dhe

sa ka me zvarritje. Në rast se do të kishte një panoramë të plotë ku 50% minimumi i çështjeve do të ishin të tilla, do të isha për ta rivlerësuar qëndrimin tim.

Petrit Çomo: Kundër.

Ridvan Hado: Kundër.

Neritan Cena: Tani, mbledhja u bë ‘flet o zonja Gjonaj, flet zoti Gjoni’, ne të tjerët të themi në fund ndonjë fjalë, që duhemi për efekt të mbushjes së kuorimit. Do doja të kisha thënë edhe unë mendimet e mia. Megjithatë, jam kundër.

Gerd Hoxha: Edhe unë bashkohem me gjitha sa thanë edhe kolegët. Për më tepër bie në sy fakti që ne po marrim për shkarkim në mënyrë jo proporcionale një gjyqtar në bazë të nenit 140 të Kushtetutës për 5 çështje, ndërkohë që ai ka gjykuar 619 çështje dhe gjyqtarja tjetër që është kryetare e gjykatës, 100 çështje më pak. Nga ana tjetër, këto çështje janë të paankimuara. Se është ajo fjala që, kur nuk i dhemb atij të Drejtorisë së Policisë, na dhemb ne. Janë të paankimuara nga vetë subjekti. Faleminderit!

Astrit Haxhialushi: Kundër.

(Nuk miratohet kërkesa e ministres për “Shkarkim nga detyra” për gjyqtarin Ahmet Jangulli.)

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë të Drejtësisë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____, 2018

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË TË DREJTËSISË
(Mbajtur, më 12.06.2018)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i Raportit nr. 1049 prot., datë 29.03.2018 “Mbi organikat e paplotësuara të gjykatave dhe mundësitë e transferimit të përkohshëm”, si dhe Raportin shtesë nr. 1895 prot., datë 07.06.2018, bazuar në vendimin e KLD-së nr. 32, datë 07.05.2018.

Drejton mbledhjen Presidenti i Republikës së Shqipërisë si dhe Kryetar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Zoti Ilir Meta.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve e Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Filloi në orën 18:45 dhe mbaroi në orën 20:03.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|------------------------------------|-------------------------|
| <i>1. Ilir Meta</i> | <i>(kryetar)</i> |
| <i>2. Etilda Gjonaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>3. Xhezair Zaganjori</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>4. Gjini Gjoni</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>5. Vangjel Kosta</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>6. Brunilda Kadi</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>7. Eneida Civici</i> | <i>(anëtare)</i> |

- | | |
|-------------------------------|------------------|
| <i>8. Petrit Çomo</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>9. Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>10. Astrit Haxhialushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>11. Gerd Hoxha</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>12. Neritan Cena</i> | <i>(anëtar)</i> |

Shënim 1: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, z. **Artan Broci**.

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Marsida Xhaferllari, Kryeinspektore pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.*
- 2. Pjerin Prendi, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.*
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit.*
- 4. Xhevdet Haxhiu, Drejtor në Drejtorinë e Administratës dhe Financës.*
- 5. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse në Sektorin e Organizimit të Mbledhjeve në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit.*
- 6. Elis Kuçi, Zëdhënës pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.*
- 7. Edlira Bako, Drejtore e Drejtorisë së Inspektimit Gjyqësor dhe Prokurorisë, përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 8. Besmir Beja, Këshilltar i Ministrisë së Drejtësisë.*
- 9. Alqi Bllako, Sekretar i Përgjithshëm i Presidentit.*
- 10. Bledar Dervishi, Këshilltar i Presidentit.*
- 11. Eksperte e Misionit EURALIUS.*
- 12. Ekspert i USAID-it.*

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i Raportit nr. 1049 prot., datë 29.03.2018 “Mbi organikat e paplotësuara të gjykatave dhe mundësitë e transferimit të përkohshëm”, si dhe Raportin shtesë nr. 1895 prot., datë 07.06.2018, bazuar në vendimin e KLD-së nr. 32, datë 07.05.2018.

Ilir Meta: ... shqyrtimin e Raportit “Mbi organikat e paplotësuara të gjykatave dhe mundësitë e transferimit të përkohshëm”, si dhe Raportin tjetër shtesë bazuar në vendimin e KLD-së nr. 32.

Atëherë, fillojmë me çështjen e dytë. Ju lutem vëmendjen tuaj.

Kërkesat për transferim të përkohshëm:

-Kërkesa për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë. Aktualisht kjo gjykatë funksionon me dy gjyqtarë. Në raport rekomandohet transferimi i përkohshëm nga 6 muaj deri në 1 vit të jo më pak se 1 gjyqtari. Atëherë, për 2 persona. Emrat e gjyqtarëve që janë këtu janë: Gjyqtare Igerta Hysi, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier; gjyqtarja Rezarta Aliu (Paja), pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet; gjyqtar Dritan Hasani, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet; gjyqtare Rudina Palloj, pranë Gjykatës së Beratit; gjyqtarja Flojera Davidhi, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë; gjyqtar Genti Dokollari, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë dhe; gjyqtarja Diamela Goxha, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

Atëherë, duhet të zgjedhim dy nga këta?

Gjin Gjoni: Atëherë, në bazë të procedurës, zoti President, duhet të krijohet një komision prej tre anëtarësh dhe njëkohësisht të bëhen fletët e votimit me secilin prej këtyre. Do bëhet një votim me firmë nga secili prej anëtarëve të KLD-së, do firmosë fletën, dhe e di administrata, dhe në fund do numërohen të gjithë fletët e votimit, që të dalë edhe rezultati.

Ilir Meta: Po, Marsida!

Po!

Vangjel Kosta: Faleminderit!

Unë kam përshtypjen që procedura që sapo u propozua është procedurë kur bëhet fjalë për karrierë apo për transferime. Ne këtu po diskutojmë të plotësojmë vende vakante në gjykata që përkohësisht janë në vështirësi për të funksionuar. Jemi në një procedurë krejt tjetër. Unë e kuptoj që për shkak të kërkesave të shumta që kemi, duket sikur në fakt jemi tek procedura e transferimit me dëshirë, gati-gati karrierë sepse duket që ka kërkesa të shumta për t’u transferuar, në një kohë që kjo është procedurë, siç thashë pak më lart, në dobi të funksionimit të gjykatës dhe jo për të favorizuar individë të ndryshëm që

kërkojnë të transferohen. Në këtë pikëpamje unë do të propozoja që procedura të ndiqte rrugën që parashikon ligji për këtë lloj procesi. Pra të evidentojmë gjykatat që do plotësohen, në rastin konkret u evidentua Gjykata e Kavajës, por të mos kalojmë tek emrat por të kalojmë tek gjykata nga e cila duhet të shkojnë gjyqtarët. Kështu ne plotësojmë tamam kriterin ligjor sipas të cilit gjykata që dëmtohet më pak nga ngarkesa, nga kjo gjykatë të largohen individët për të plotësuar gjykatën e cila ka nevojë. Në të kundërt, unë kam frikë se ne do të krijojmë një perceptim shumë negativ për Këshillin e Lartë të Drejtësisë, sipas të cilit, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me idenë e transferimit të përkohshëm, në fakt, po bën ca transferime karriere dhe mua kjo më shqetëson shumë. Faleminderit!

Gjin Gjoni: Faleminderit, zoti President!

Të them të drejtën, ky transferimi i përkohshëm është pak ekstra-procedural, por duke qenë se të gjithë kryetarët e gjykatave, për kandidatët të cilët kanë paraqitur kërkesë, kanë dhënë pëlqimin e tyre, kjo është pak a shumë një procedurë normale. Në rast se kryetarët e gjykatave nuk do kishin dhënë pëlqimin, atëherë ne do shihnim mbi bazën e gjykatave, ngarkesën që kishte secila prej tyre. Por duke qenë se kjo listë që është paraqitur dhe duke qenë se për dy vende janë rreth 10 veta, është e pamundur që një votim të bëhet sepse njëri mund të votojë për të parin ose për të tetin, i dyti mund të votojë... dhe është e pamundur për t'u mbledhur votimi.

Ilir Meta: Marsida!

Marsida Xhaferllari: Kjo është një çështje e mbartur nga mbledhja e datës 7 maj 2018 dhe në raportin bazë që u përgatit është përshkruar e gjithë procedura që parashikon ligji për transferimin e përkohshëm. Pra bëhet fjalë për transferim të përkohshëm, nuk do jetë transferim i përhershëm. Në qoftë se do i referohemi me afat, 1 vit është maksimumi. Në qoftë se do i referohemi raportit bazë, janë identifikuar edhe gjykatat nga mund të vijnë të transferuarit, të kombinuar edhe me efektet financiare.

Ligji ka edhe një kërkesë ndër të tjera, pëlqimin e gjyqtarit, dhe duke marrë në konsideratë këtë, në mbledhjen e datës 07.05. ishte vetë Këshilli i Lartë i Drejtësisë që vendosi të njoftojë publikisht të gjithë gjyqtarët që kanë interes.

(Zoti President pyet pa ndezur mikrofonin mbi procedurën që duhet të ndiqet në mbledhje.)

Vangjel Kosta: Unë vetëm përsërita procedurën që është propozuar në materialin e datës 29.03. të këtij Këshilli. Pra atje është operuar pikërisht me këtë që unë sapo thashë. Është evidentuar pikërisht gjykata nga e cila duhet të vijnë gjyqtarët për gjykatën që ka nevojë dhe pastaj, natyrisht, mbi këtë, do diskutohen emrat në kuptimin e kritereve që mund të plotësojë secili.

Gerd Hoxha: Faleminderit, zoti President!

Është e vërtetë kjo që thotë Profesori, por në mbledhjen pasardhëse ne e thamë dhe e vlerësuam këtë si kriter më transparent dhe thamë që nuk kemi pse e kufizojmë vetëm tek këto gjykata, sepse ligji tashmë ka ndërruar, nuk e përcakton më kriterin e largësisë e gjykatës më të afërt, por e lejon nga të gjitha gjykatat, për këtë arsye ne e shpallëm të hapur për të gjithë gjykatat dhe kjo na bëri më transparent dhe i jep më kuptim...

Ilir Meta: Si e kishit menduar ju Marsida për sot?

Marsida Xhaferllari: Neve e kemi menduar që të gjitha të dhënat janë të plota për anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Mënyra e zgjedhjes është që duke pasur në konsideratë gjyqtarët, emrat e gjyqtarëve, gjykatat nga vijnë, ngarkesën sasiore që kanë secila gjykatë nga ata vijnë, secili anëtar i KLD-së është i lirë të bëjë vlerësimin a përmbushen kushtet e ligjit apo jo. Edhe kuadri ligjor është në dispozicion.

(Disa nga anëtarët flasin pa ndezur mikrofonat.)

Me fletë votimi.

Xhezair Zaganjori: Po shoh gjykatat që kanë nevojë për gjyqtarë. Në fakt, të gjitha gjykatat kanë nevojë sepse jemi në një gjendje aspakt të zakonshme dhe ngarkesa është shumë e madhe dhe të gjithë gjykatat kanë nevojë.

Unë do të thoja që këtu më shumë se gjysma e gjykatave janë gjykatat administrative të shkallës së parë. Është një problem që tashmë dihet. Që në vitin 2013 kur u krijuan këto gjykata janë me mungesa të ndjeshme, por ama këto në të njëjtën kohë kanë pasur le të themi “një fat” që janë në rrethe të mëdha dhe janë ndihmuar nga gjykatat e zakonshme. Dhe mendoj që ndoshta nuk është momenti që të lëvizim gjyqtarë

në këto gjykata sepse pak a shumë problemi është zgjidhur dhe është krijuar një lloj praktike pune më shumë se 5-vjeçare dhe kam përshtypjen që duke i lëvizur gjyqtarët pastaj do krijojmë... pastaj, sigurisht që gjyqtarët kanë dëshirë të lëvizin sepse janë rrethe të mëdha këto dhe të afrohen disi. Nuk e di. Por kam përshtypjen që më urgjente paraqitet nevoja për të dërguar gjyqtarë në Kavajë, në Kukës dhe tek Gjykata Administrative e Apelit, mbase. Nuk e di. Por këto të tjerat, gjykatat administrative të shkallës së parë, nuk e di nëse paraqitet ndonjë nevojë urgjente për të bërë lëvizje të tilla në këto gjykata sot apo jo. Them që më tepër do të krijonte problemin në praktikë sesa do ta shëndoshte.

Petrit Çomo: Them mos ka ndonjë pasaktësi të vogël tek kjo se studimi është bërë tek gjykatat që ka nevojë dhe këtu thotë “Gjykata Administrative e Shkodrës ka nevojë dhe ka kandiduar njëri nga Puka, ndërsa më poshtë, një person që është tek Gjykata Administrative e Shkodrës, thotë do iki nga Gjykata Administrative e Shkodrës”. Po ç’rëndësi ka? Kjo gjykatë, në qoftë se ka mundësi t’i iki gjyqtari, pse kërkon gjyqtarë atëherë?

Ilir Meta: Nejse! Më fal, më fal.

Ju lutem! Se unë isha informuar që kjo çështje zgjidhej me votim këtu, pra jo me këtë procedurë që thotë zoti... Po mirë, nuk thashë unë. Unë nuk jam për të bërë gjëra të pamundura. Unë jam për të bërë gjëra të mundura. Kam të pamundur kohën që të rrijë edhe 1 orë ose 2 orë këtu. Më kupton? Sepse kështu më ishte thënë. Nuk është as faji im as faji yt.

Megjithatë, duhet të lemë një ditë tjetër. Në qoftë se jeni gati nesër, unë edhe nesër gati jam për të bërë këtë procedurë.

Petrit Çomo: Nesër është pritja në Ambasadën Angleze.

Për juve po them.

Ilir Meta: Po nuk thashë në atë orë. Mendova orë tjetër.

Sa zgjat kjo procedurë?

(Disa nga anëtarët flasin pa ndezur mikrofonat.)

E lemë nesër në orën 04:00?

Më fal, në orën 04:00.

Mirë atëherë, në orën 04:00 nesër. Saktësoni procedurat të gjitha si duhen bërë.

(Zonja Kadi flet pa ndezur mikrofonin.)

Do i bëjmë ne delegimet tani.

Për mua nuk ka problem, por mos ju vonojnë këto...

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë të Drejtësisë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____, 2018

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË TË DREJTËSISË
(Mbajtur, më 12.06.2018)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i Rekomandimit të Avokatit të Popullit “Mbi veprimtarinë e institucioneve të Policisë së Shtetit, Prokurorisë dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, në lidhje me trajtimin e rastit të tubimit të datës 31.03.2018 në Rrugën e “Kombit”, për kundërshtimin e tarifës së vendosur për kalimin në këtë rrugë”.

Drejton mbledhjen Presidenti i Republikës së Shqipërisë si dhe Kryetar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Zoti Ilir Meta.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve e Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Filloi në orën 18:45 dhe mbaroi në orën 20:03.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Ilir Meta*** (kryetar)
2. ***Etilda Gjonaj*** (anëtare)
3. ***Xhezair Zaganjori*** (anëtar)
4. ***Gjin Gjoni*** (anëtar)
5. ***Vangjel Kosta*** (anëtar)
6. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
7. ***Eneida Civici*** (anëtare)

- | | |
|-------------------------------|------------------|
| 8. Petrit Çomo | (anëtare) |
| 9. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 10. Astrit Haxhialushi | (anëtar) |
| 11. Gerd Hoxha | (anëtar) |
| 12. Neritan Cena | (anëtar) |

Shënim 1: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, z. **Artan Broci**.

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Marsida Xhaferllari, Kryeinspektore pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.**
- 2. Pjerin Prendi, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.**
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit.**
- 4. Xhevdet Haxhiu, Drejtor në Drejtorinë e Administratës dhe Financës.**
- 5. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse në Sektorin e Organizimit të Mbledhjeve në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit.**
- 6. Elis Kuçi, Zëdhënës pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.**
- 7. Edlira Bako, Drejtore e Drejtorisë së Inspektimit Gjyqësor dhe Prokurorisë, përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.**
- 8. Besmir Beja, Këshilltar i Ministrisë së Drejtësisë.**
- 9. Alqi Bllako, Sekretar i Përgjithshëm i Presidentit.**
- 10. Bledar Dervishi, Këshilltar i Presidentit.**
- 11. Eksperte e Misionit EURALIUS.**
- 12. Ekspert i USAID-it.**

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtimi i Rekomandimit të Avokatit të Popullit “Mbi veprimtarinë e institucioneve të Policisë së Shtetit, Prokurorisë dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, në lidhje me trajtimin e rastit të tubimit të datës 31.03.2018 në Rrugën e “Kombit”, për kundërshtimin e tarifës së vendosur për kalimin në këtë rrugë”.

Ilir Meta: Ilir Meta: Kalojmë tek pika e tretë e rendit të ditës. Shqyrtimi i Rekomandimit të Avokatit të Popullit “Mbi veprimtarinë e institucioneve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, Policisë së Shtetit dhe Prokurorisë, në lidhje me trajtimin e rastit të tubimit ... në Rrugën e “Kombit”, për kundërshtimin e tarifës së vendosur për kalimin në këtë rrugë”.

Nuk e di a keni lexuar apo jo.

Pra kërkohet nisja e procesit të verifikimit apo hetimit disiplinor nga IKLD-së për zonjën Alma Ahmeti, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës, e cila ka shqyrtuar çështjen gjyqësore të masave të sigurimit ndaj protestuesve në Rrugën e “Kombit”, të cilët janë proceduar penalisht. Bazuar në faktet që do të mund të rezultojnë nga raporti i Inspektoratit të KLD-së, mund të vijohet më tej për procedimin disiplinor ose jo të gjyqtares. Pra ky është thelbi i kësaj çështjeje.

Kush ka për të shprehur ndonjë mendim?

Atëherë, jemi dakord që të nisi procesi i verifikimit të...?

Po, po!

Etilda Gjonaj: Të paktën me sa pashë nga rekomandimi i Avokatit të Popullit, është objekt i veprimtarisë së Inspektoratit të KLD-së dhe është kompetencë e këtij Inspektorati të përcaktojë dhe të vlerësojë nëse në rekomandimin e Avokatit të Popullit ka rrethana që do të sillnin fillimin e një hetimi disiplinor për çështjen në fjalë. Dhe, nuk mendoj që duhet të jetë pjesë e vendimmarrjes së Këshillit të Lartë të Drejtësisë nëse Inspektorati duhet të fillojë, pra në kuadër dhe në zbatim të rekomandimit të Avokatit të Popullit, duhet të fillojë hetimin apo jo. Kjo është pikërisht brenda kompetencave të Inspektoratit të KLD-së.

Ilir Meta: Po, Marsida!

Marsida Xhaferllari: Siç thotë ministrja, në parim ashtu thotë ligji, por raporti që ka ardhur nga Avokati i Popullit dhe sipas ligjit kërkon një përgjigje për përmbushjen e rekomandimit brenda 30 ditëve nga marrja e raportit, është dërgimi i këtij rekomandimi pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë për të vlerësuar për çështje që mund të ndiqen prej tyre deri në krijimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Kjo ka qenë arsyeja që Inspektorati ka bërë një material paraprak, ku ia ka bërë me njohje të gjithë anëtarëve të KLD-së dhe

kërkojmë dritën jeshile ose më saktë, një lloj konfirmimi, që t'i japim përgjigje edhe Avokatit të Popullit që, ne e morëm këtë rekomandim, u diskutua në mbledhjen plenare të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe hapat e radhës do të jenë këto. Kjo ka qenë ideja që është paraqitur për diskutim.

Ilir Meta: Po!

Më fal!

Unë mendoj që institucioni i Avokatit të Popullit është institucion shumë i rëndësishëm. Ka kërkuar që ne të jemi në dijeni dhe të shprehim një vlerësim për këtë çështje dhe mendoj që Inspektorati juaj, pa dyshim që duhet të ndjekë të gjitha ato shqetësime që ka ngritur Avokati i Popullit. Pastaj ju i shikoni vetë nëse ato qëndrojnë apo nuk qëndrojnë.

Po, zoti Gjoni!

Dakord?

Kështu që ju e keni dritën jeshile.

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë të Drejtësisë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____, 2018

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË TË DREJTËSISË
(Mbajtur, më 12.06.2018)

Pika 4 e rendit të ditës me objekt: Delegimet.

Drejton mbledhjen Presidenti i Republikës së Shqipërisë si dhe Kryetar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Zoti Ilir Meta.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve e Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Filloi në orën 18:45 dhe mbaroi në orën 20:03.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|------------------------------|------------------|
| 1. Ilir Meta | (kryetar) |
| 2. Xhezair Zaganjori | (anëtar) |
| 3. Gjini Gjoni | (anëtar) |
| 4. Vangjel Kosta | (anëtar) |
| 5. Brunilda Kadi | (anëtare) |
| 6. Eneida Civici | (anëtare) |
| 7. Petrit Çomo | (anëtare) |
| 8. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 9. Astrit Haxhialushi | (anëtar) |
| 10. Gerd Hoxha | (anëtar) |

Shënim 1: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, z. **Artan Broci**.

Shënim 2: Zonja Gjonaj largohet dhe nuk merr pjesë në trajtimin e kësaj pike.

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. **Marsida Xhaferllari, Kryeinspektore pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.**
2. **Pjerin Prendi, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.**
3. **Vildan Kaloshi, Drejtor në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit.**
4. **Xhevdet Haxhiu, Drejtor në Drejtorinë e Administratës dhe Financës.**
5. **Krisulla Kasaj, Përgjegjëse në Sektorin e Organizimit të Mbledhjeve në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit.**
6. **Elis Kuçi, Zëdhënës pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.**
7. **Edlira Bako, Drejtore e Drejtorisë së Inspektimit Gjyqësor dhe Prokurorisë, përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.**
8. **Besmir Beja, Këshilltar i Ministrisë së Drejtësisë.**
9. **Alqi Bllako, Sekretar i Përgjithshëm i Presidentit.**
10. **Bledar Dervishi, Këshilltar i Presidentit.**
11. **Eksperte e Misionit EURALIUS.**
12. **Ekspert i USAID-it.**

RENDI I DITËS:

4. Delegimet.

Ilir Meta: Atëherë, kalojmë tek delegimet?

Tek delegimet Gjini dhe Gerdi dhe Brunilda.

Marsida Xhaferllari: Paraprakisht iu janë bërë me dije në relacion tre çështje paraprake. Çështja e parë ka të bëjë me një kërkesë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë e cila evidenton përballimin e shpenzimeve nga procesi i delegimit. Ne këtë

çështje e kemi sugjeruar që të merret mendim i specializuar nga Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor dhe t'i kthehet përgjigje Gjykatës së Rrethit Tiranë. Çështja e dytë ka të bëjë nga... është e ngritur nga kryetari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, i cili pretendon se automjetet që ka në dispozicion gjykata nuk janë në gjendjen e duhur dhe ai nuk mund të garantojë transportin e sigurt të gjyqtarëve që delegohen dhe mundësisht, KLD mos të delegojë më gjyqtarë nga Gjykata e Vlorës. Dhe çështja e tretë është nga Gjykata e Apelit Korçë, është bërë një gabim material në mbledhjen e fundit. Është deleguar gabimisht gjyqtarja Nure Dreni e cila në fakt ishte përjashtuar. Për këtë arsye sugjerohet që kjo çështje të përfshihet tek rendi i sotëm për delegim. Dhe çështja e fundit i përket Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin që ka kërkuar një çështje për delegim, që është ndreqje e gabimeve dhe sqarim vendimi dhe kërkon/sugjeron kryetari i gjykatës që të delegohen të njëjtët gjyqtarë që kanë marrë pjesë në themelin e çështjes.

Petrit Çomo: Kjo është kërkesë e drejtë.

Dy të parat t'i përcillen ZABGJ-së. Ajo gjyqtarja që është komanduar gabim duhet të ndryshohet. Edhe ajo e Kurbinut është në rregull. Për sa i përket makinave, s'kemi mundësi. T'i themi ZABGJ-së të na japi makinë, por jo të mos komandojmë gjyqtarë.

Marsida Xhaferllari: Kalojmë atëherë në çështjen nr. 1, nga Gjykata e Apelit Tiranë, në Gjykatën e Apelit Durrës, kërkohet 1 gjyqtar, por Zegjine Sollaku dhe Ilir Toska kanë pengesë. Kërkohet 1 gjyqtar për çështjen nr. 1.

Gjin Gjoni: Flutra Skënderi.

Marsida Xhaferllari: Për çështjen nr. 2 hidh shortin mes gjykatave: apeli Shkodër, apeli Tiranë, apeli Korçë, apeli i krimeve të rënda. Për të shkuar në Durrës. Apeli Shkodër, apeli Tiranë, apeli Korçë, apeli i krimeve të rënda.

Gjin Gjoni: Apeli i krimeve të rënda.

Marsida Xhaferllari: Apeli i krimeve të rënda. Kërkohen 2 gjyqtarë.

Gjin Gjoni: Saida, Nure.

Marsida Xhaferllari: Saida Dollani dhe Nure Dreni.

Çështja nr. 3, po aty, 2 gjyqtarë.

Gjin Gjoni: Idrizi dhe Guraliu.

Marsida Xhaferllari: Idriz Mulkurti dhe Gurali Brahimllari.

Vazhdojmë po aty, për çështjen nr. 4, 1 gjyqtar.

Gjin Gjoni: Gjovalin Përnoca.

Marsida Xhaferllari: Gjovalin Përnoca.

Për çështjen nr. 5 vijojmë po aty, 3 gjyqtarë.

Gjin Gjoni: Nure Dreni.

Marsida Xhaferllari: Nure Dreni.

Gjin Gjoni: Albana Boksi.

Marsida Xhaferllari: Albana Boksi.

Gjin Gjoni: Idrizi.

Marsida Xhaferllari: Idriz Mulkurti.

Vijojmë po aty, për çështjen nr. 6, 2 gjyqtarë.

Gjin Gjoni: Dhimitër Lara

Marsida Xhaferllari: Dhimitër Lara. Edhe një tjetër.

Gjin Gjoni: Sokol Binaj.

Marsida Xhaferllari: Sokol Binaj.

Hedhim shortin mes gjykatave për të shkuar në apel Gjirokastrë, mes apelit Korçë, apelit Vlorë, apelit të krimeve të rënda. (Çështja nr. 7)

Gjin Gjoni: Apeli i krimeve të rënda.

Marsida Xhaferllari: 3 gjyqtarë.

Gjin Gjoni: Dhurata Haveri.

Marsida Xhaferllari: Dhurata Haveri. Tjetër.

Gjin Gjoni: Nertina Kosova.

Marsida Xhaferllari: Nertina Kosova. Edhe një tjetër.

Gjin Gjoni: Saida.

Marsida Xhaferllari: Saida Dollani.

Vijojmë po aty për çështjen nr. 8, 2 gjyqtarë.

Gjin Gjoni: Sokol Binaj.

Marsida Xhaferllari: Sokol Binaj. Edhe një tjetër.

Gjin Gjoni: Dhimitër Lara.
Marsida Xhaferllari: Dhimitër Lara.
Për çështjen nr. 9, po aty, 2 gjyqtarë.
Gjin Gjoni: Idrizi.
Marsida Xhaferllari: Idriz Mulkurti.
Gjin Gjoni: Albana.
Marsida Xhaferllari: Albana Boksi.
Për çështjen nr. 10, po aty, 1 gjyqtar.
Gjin Gjoni: Guraliu.
Marsida Xhaferllari: Gurali Brahimllari.
Për çështjen nr. 11, po aty, për të shkuar në Gjykatën e Apelit Korçë. 1 gjyqtar.
Është ajo çështja që përmendëm tek paraparakët që ishte deleguar gabim Nure Dreni që ka pengesë. Ka pengesë Dhurata Haveri, Binaj, Nure Dreni, Albana Boksi, Saida Dollani.
Gjin Gjoni: Albana Boksi.
Marsida Xhaferllari: Ka pengesë.
Gjin Gjoni: Guraliu.
Marsida Xhaferllari: Jo!
Gjin Gjoni: Nurja.
Marsida Xhaferllari: Nurja ka pengesë.
Gjin Gjoni: Dhurata.
Marsida Xhaferllari: Dhurata Haveri ka pengesë.
Gjin Gjoni: Gjovalin Përnoca.
Marsida Xhaferllari: Gjovalin Përnoca.
Tek çështja nr. 12 hidh shortin mes gjykatave për të shkuar në apel Korçë, mes apelit Gjirokastrë, apelit Vlorë, apelit Durrës, apelit të krimeve të rënda.
Gjin Gjoni: Apeli Vlorë.
Marsida Xhaferllari: Apeli Vlorë, 2 gjyqtarë.
Gjin Gjoni: Petriti me Skënderin.
Marsida Xhaferllari: Petrit Aliaj, Skender Damini.
Tek 13-ta, po aty, 1 gjyqtar.

Gjin Gjoni: Sokol Ngresi.
Marsida Xhaferllari: Sokol Ngresi.
Tek 14, po aty, 3 gjyqtarë.
Gjin Gjoni: Margarita.
Marsida Xhaferllari: Margarita Buhali. Tjetër.
Gjin Gjoni: Hysen Saliko.
Marsida Xhaferllari: Hysen Saliko. Edhe një tjetër.
Gjin Gjoni: Iliba.
Marsida Xhaferllari: Iliba Bezati.
Tek 15, po aty, tre gjyqtarë.
Gjin Gjoni: Brikena, Nazmiu, Klodiana.
Marsida Xhaferllari: Brikena Lubonja, Nazmi Troka, Klodiana Gjyzari.
Vazhdojmë po aty, 1 gjyqtar. Për 16.
Gjin Gjoni: Sokol Ngresi.
Marsida Xhaferllari: Sokol Ngresi.
Për 17, 3 gjyqtarë.
Gjin Gjoni: Brikena, Hyseni, Nazmiu.
Marsida Xhaferllari: Brikena Lubonja, Hysen Saliko, Nazmi Troka.
Tek 18, po aty, 1 gjyqtar.
Gjin Gjoni: Skënder Damini.
Marsida Xhaferllari: Skënder Damini.
Tek 19, shorti mes gjykatave për të shkuar në apel Shkodër, midis apelit Durrës,
apelit Vlorë, apelit Tiranë, apeli të krimeve të rënda.
Gjin Gjoni: Apeli Tiranë.
Marsida Xhaferllari: Apeli Tiranë. 3 gjyqtarë.
Gjin Gjoni: Malaj.
Marsida Xhaferllari: Alaudin Malaj. Tjetër.
Gjin Gjoni: Artur Gaxhi.
Marsida Xhaferllari: Artur Gaxhaj. Tjetër.
Gjin Gjoni: Fatos Qato.

Marsida Xhaferllari: Fatos Qato.

Atëherë, për të shkuar në Gjykatën e Apelit Tiranë, mes apelit Shkodër, apelit Durrës dhe apelit të krimeve të rënda. (Çështja nr. 20)

Gjin Gjoni: Apeli Durrës.

Marsida Xhaferllari: Apeli Durrës. 3 gjyqtarë.

Gjin Gjoni: Arben Vrioni, Arjan Balliu, Izet Dushaj.

Marsida Xhaferllari: Arben Vrioni, Arjan Balliu, Izet Dushaj.

Tek 21, nga apeli Vlorë tek apeli i krimeve të rënda.

Gjin Gjoni: Brunilda.

Marsida Xhaferllari: Brunilda, si e ka mbiemrin?

Ku ka Brunilda.

Gjin Gjoni: Lubonja.

Marsida Xhaferllari: Brikena Lubonja.

Nga Rrethi Gjyqësor Tiranë në shkallën e parë për krime të rënda (Dhoma Penale), 3 gjyqtarë. Me gjyqtarë mbi 5 vjet se shkojnë tek krimet e rënda.

Gjin Gjoni: Altin Abdiu, Artan Gjermani, Albert Meçe.

Marsida Xhaferllari: Altin Abdiu. Artan Gjermani. Albert Meçe.

Tek 23, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë në Elbasan (nga Dhoma Penale), 1 gjyqtar, por jo Bledar Abdullahi se ka pengesë.

Gjin Gjoni: Sokol Tona.

Marsida Xhaferllari: Sokol Tona.

Tek 24, 1 gjyqtar. Nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë në Rrethin Gjyqësor Elbasan.

Gjin Gjoni: Bledar Abdullahi.

Marsida Xhaferllari: Bledar Abdullahi.

Nga rrethi gjyqësor Sarandë në rrethin gjyqësor Gjirokastrë, 1 gjyqtar, por jo Enkeleda Goda, jo Ketra Bajrami. Pra mes Nevrie Dukës dhe Sokol Pinës. (Çështja nr. 25)

Gjin Gjoni: Sokol Pina.

Marsida Xhaferllari: Sokol Pina.

26, 1 gjyqtar nga rrethi gjyqësor Durrës në rrethin gjyqësor Kavajë.

Gjin Gjoni: Paulin Çera.

Marsida Xhaferllari: Paulin Çera.

Vazhdojmë po aty, 1 gjyqtar për 27.

Gjin Gjoni: Petraq Çuri.

Marsida Xhaferllari: Petraq Çuri.

Tek 28, 1 gjyqtar nga rrethi gjyqësor Durrës... Rexhep Bekteshi ka pengesë.

Gjin Gjoni: Eda Kaja.

Marsida Xhaferllari: Për 29. Nga rrethi gjyqësor Durrës në rrethin gjyqësor Kavajë, 1 gjyqtar.

Gjin Gjoni: Nurjeta Tafa.

Marsida Xhaferllari: Nurjeta Tafa.

30, 1 gjyqtar, po aty. Dhoma Penale.

Gjin Gjoni: Rexhep Bekteshi.

Marsida Xhaferllari: Rexhep Bekteshi.

Po aty, 1 gjyqtar për 31.

Gjin Gjoni: Petraqi.

Marsida Xhaferllari: Petraq Çuri.

Për 32, po aty 1 gjyqtar.

Gjin Gjoni: Paulini.

Marsida Xhaferllari: Paulin Çera.

Po aty, 1 gjyqtar për 33.

Gjin Gjoni: Eda Kaja.

Marsida Xhaferllari: Eda Kaja.

Po aty, 1 gjyqtar për 34.

Gjin Gjoni: Petraq Çuri.

Marsida Xhaferllari: Petraq Çuri.

Tek 35, po aty 1 gjyqtar.

Gjin Gjoni: Eda Kaja.

Marsida Xhaferllari: Eda Kaja.

Po aty, 1 gjyqtar për 36.

Gjin Gjoni: Nurjeta Tafa.

Marsida Xhaferllari: Nurjeta Tafa.

Po aty, 1 gjyqtar për 37.

Gjin Gjoni: Paulin Çera.

Marsida Xhaferllari: Paulin Çera.

Po aty, 1 gjyqtar për 38.

Gjin Gjoni: Rexhep Bekteshi.

Marsida Xhaferllari: Rexhep Bekteshi.

Po aty, 1 gjyqtar për 39.

Gjin Gjoni: Nurjeta Tafa.

Marsida Xhaferllari: Nurjeta Tafa.

Po aty, 1 gjyqtar për 40.

Gjin Gjoni: Eda Kaja.

Marsida Xhaferllari: Eda Kaja.

Për 41, po aty, 1 gjyqtar.

Gjin Gjoni: Rexhep Bekteshi.

Marsida Xhaferllari: Rexhep Bekteshi.

Po aty, 1 gjyqtar, por Nurjeta Tafa ka pengesë. Për 42.

Gjin Gjoni: Petraq Çuri.

Marsida Xhaferllari: Petraq Çuri.

Po aty, 1 gjyqtar për 43.

Gjin Gjoni: Paulin Çera.

Marsida Xhaferllari: Paulin Çera.

1 gjyqtar për 44.

Gjin Gjoni: Eda Kaja.

Marsida Xhaferllari: Eda Kaja.

45, po aty, 1 gjyqtar.

Gjin Gjoni: Nurjeta Tafa.

Marsida Xhaferllari: Nurjeta Tafa.

46, Dhoma Civile e Durrësit për në Kavajë, 1 gjyqtar.

Gjin Gjoni: Besjana Garxenaj.

Marsida Xhaferllari: Besjana Garxenaj.

Nga rrethi gjyqësor Kurbin në rrethin gjyqësor Krujë, 1 gjyqtar. (Çështja nr. 47)

Gjin Gjoni: Ded Miri.

Marsida Xhaferllari: Ded Miri.

48, 1 gjyqtar nga rrethi gjyqësor Kurbin, në Krujë.

Gjin Gjoni: Aureli.

Marsida Xhaferllari: Aurel Arapi.

Po aty, 1 gjyqtar për 49.

Gjin Gjoni: Marçela.

Marsida Xhaferllari: Marçela Shehu.

Po aty 1 gjyqtar, por Ded Miri ka pengesë. (Çështja nr. 50)

Gjin Gjoni: Aureli.

Marsida Xhaferllari: Aurel Arapi.

Po aty për 51, por Ded Miri ka pengesë.

Gjin Gjoni: Marçela.

Marsida Xhaferllari: Marçela Shehu.

Po aty, 1 gjyqtar, mes të treve. (Çështja nr. 52)

Gjin Gjoni: Aureli.

Marsida Xhaferllari: Aurel Arapi.

1 gjyqtar, po aty, mes të treve. (Çështja nr. 53)

Gjin Gjoni: Deda.

Marsida Xhaferllari: Ded Miri.

54, nga rrethi gjyqësor Tiranë në rrethin gjyqësor Krujë, 1 gjyqtar, jo Aurel Arapi,
jo Ded Miri.

Gjin Gjoni: Anila Kristani.

Marsida Xhaferllari: Anila Kristani.

Tek 55, 1 gjyqtar, nga Tropoja në Kukës mes Erjon Çelës dhe Sami Ujkashit.

Gjin Gjoni: Samiu.

Marsida Xhaferllari: Sami Ujkashi.

Tek 56, 3 gjyqtarë mes gjyqtarëve të bashkuar të Tropojës dhe Pukës.

Gjin Gjoni: Samiu, Gentjani dhe Erjoni.

Marsida Xhaferllari: Sami Ujkashi, Gentjan Marku dhe Erjon Çela.

1 gjyqtar nga Kruja në Kurbin mes Engjellushe Tahiri dhe Enkeleda Hoxhës.

(Çështja nr. 57)

Gjin Gjoni: Engjellushja.

Marsida Xhaferllari: Engjellushe Tahiri.

58 është relatuar tek çështjet paraprake, Artan Hajredinaj, Ilir Përdeda, Jak Ndoka.

Tek 59, nga Kurbin në Lezhë, 1 gjyqtar. Mes Marcela Shehu, Ded Miri dhe Aurel Arapit.

Gjin Gjoni: Marçela.

Marsida Xhaferllari: Marcela Shehu.

Nga rrethi gjyqësor Fier (Dhoma Penale) në Lushnje, 1 gjyqtar. (Çështja nr. 60)

Gjin Gjoni: Matilda.

Marsida Xhaferllari: Matilda Shalla.

Nga rrethi gjyqësor Kurbin, në Mat, 1 gjyqtar, por jo Marcela Shehu. Mes Ded Mirit dhe Aurel Arapit. (Çështja nr. 61)

Gjin Gjoni: Ded Miri.

Marsida Xhaferllari: Ded Miri.

Nga Dhoma Civile e rrethit gjyqësor Shkodër në Pukë, 1 gjyqtar për 62.

Gjin Gjoni: Ermira Dedja.

Marsida Xhaferllari: Ermira Dedja.

Për 63, nga Korça në Pogradec, rrethi gjyqësor, 1 gjyqtar (Dhoma Penale).

Gjin Gjoni: Luljeta Kole.

Marsida Xhaferllari: Kole.

64, nga rrethi gjyqësor Gjirokastrë, në Sarandë, 1 gjyqtar, por jo Blerta Çibuku se ka pengesë.

Gjin Gjoni: Arben Dosti.

Marsida Xhaferllari: Arben Dosti.

Nga rrethi gjyqësor Gjirokastrë, gjyqtarët me 5 vjet vjetërsi, në administrative shkalla e parë Gjirokastrë, 1 gjyqtar. Mes tre gjyqtarëve: Çibuku, Vehbiu, Iliopulli. 1 gjyqtar për 65.

Gjin Gjoni: Mirela.

Marsida Xhaferllari: Mirela Iliopulli.

Nga rrethi gjyqësor Gjirokastrë, në administrative shkallë e parë Gjirokastrë, 1 gjyqtar mes gjyqtarëve me 5 vite vjetërsi. 66.

Gjin Gjoni: Blerta.

Marsida Xhaferllari: Blerta Çibuku.

Nga rrethi gjyqësor Gjirokastrë në administrative Gjirokastrë, 1 gjyqtar. Po aty për 67.

Gjin Gjoni: Pëllumbi.

Marsida Xhaferllari: Pëllumb Vehbi.

Për 68, po aty 1 gjyqtar.

Gjin Gjoni: Pëllumbi prapë.

Marsida Xhaferllari: Pëllumb Vehbi.

Tek 69, nga rrethi Korçë, gjyqtarët mbi 5 vjet, në administrative Korçë, 1 gjyqtar.

Gjin Gjoni: Markeliani.

Marsida Xhaferllari: Markelian Kuqo.

Po aty 1 gjyqtar për 70.

Gjin Gjoni: Sonjela Voskopi.

Marsida Xhaferllari: Sonjela Voskopi.

(Shtesa nr.1)

Shorti mes gjykatave: apel Shkodër, apel Tiranë, apel Korçë, apeli i krimeve të rënda, për të shkuar në apel Durrës, për çështjen nr. 1 tek shtesa e datës 11.06.

Gjin Gjoni: Apeli Tiranë.

Marsida Xhaferllari: Apeli Tiranë. 1 gjyqtar.

Gjin Gjoni: Ervin Metalla.

Marsida Xhaferllari: Ervin Metalla.

Për çështjen nr. 2 nga rrethi Përmet në rrethin gjyqësor Gjirokastrë, mes Dritan Hasanit dhe Rezarta Pajës, 1 gjyqtar.

Gjin Gjoni: Rezarta.

Marsida Xhaferllari: Rrezarta Paja.

Për çështjen nr. 3, nga Përmeti në Gjirokastrë, mes Dritan Hasanit dhe Rezarta Pajës, 1 gjyqtar.

Gjin Gjoni: Dritani.

Marsida Xhaferllari: Dritan Hasani.

Nga Kurbin, në Krujë, 1 gjyqtar mes Ded Mirit, Marçela Shehut, Aurel Arapit. (Çështja nr. 4)

Gjin Gjoni: Aureli.

Marsida Xhaferllari: Aurel Arapi.

Po aty, 1 gjyqtar për 5.

Gjin Gjoni: Ded Miri.

Marsida Xhaferllari: Nga Lezha Jak Ndoka, Elsa Ulliri, Artan Hajredinaj, 1 gjyqtar për të shkuar në Kurbin. (Çështja nr. 6)

Gjin Gjoni: Ilir Përdeda.

Marsida Xhaferllari: Jo, Ilir Përdeda ka pengesë.

Gjin Gjoni: Jak Ndoka.

Marsida Xhaferllari: Po aty, mes të katër gjyqtarëve për të shkuar në Kurbin, 1 gjyqtar për 7.

Gjin Gjoni: Artan Hajredinaj.

Marsida Xhaferllari: Artan Hajredinaj.

Po aty, por Elsa Ulliri ka pengesë, për të shkuar në Kurbin.

Gjin Gjoni: Ilir Përdeda.

Marsida Xhaferllari: Ilir Përdeda për 8-ën.

Po aty, 1 gjyqtar mes të katërve, për të shkuar në Kurbin për 9-ën.

Gjin Gjoni: Artan Hajredinaj.

Marsida Xhaferllari: Artan Hajredinaj.

Po aty, 1 gjyqtar për 10-ën mes të katërve.

Gjin Gjoni: Elsa Ulliri.

Marsida Xhaferllari: Elsa Ulliri.

Nga Dhoma Penale e rrethit Shkodër për të shkuar në Pukë, 1 gjyqtar por jo Arbër Çela dhe jo Tonin Stërkaj se kanë pengesë. (Çështja nr. 11)

Gjin Gjoni: Sokol Shehu.

Marsida Xhaferllari: Sokol Shehu.

Shtesa e fundit. Nga rrethi Kurbin në Krujë, 1 gjyqtar, mes Ded Mirit, Marçela Shehut, Aurel Arapit.

Gjin Gjoni: Marçela.

Marsida Xhaferllari: Marçela Shehu.

Po aty, 1 gjyqtar për 2-shin.

Gjin Gjoni: Aureli.

Marsida Xhaferllari: Aurel Arapi.

Po aty, 1 gjyqtar për 3-shin.

Gjin Gjoni: Ded Miri.

Marsida Xhaferllari: Ded Miri.

Nga Dhoma Penale e rrethit Tiranë për të shkuar në rrethin Krujë, 1 gjyqtar. (Çështja nr. 4)

Gjin Gjoni: Vjollca Spahiu.

Marsida Xhaferllari: Vjollca Spahiu.

Tek 5, nga Lezha në Kurbin, 1 gjyqtar.

Gjin Gjoni: Ilir Përdeda.

Marsida Xhaferllari: Ilir Përdeda.

Dhe e fundit, nga Kurbin në Lezhë, 1 gjyqtar

Gjin Gjoni: Ded Miri.

Marsida Xhaferllari: Ded Miri.

Përfunduar.

Ilir Meta: Atëherë, me delegimet mbaruar. Mbyllet mbledhja për sot.

Mirupafshim nesër në orën 16:00.

Natën e mirë!

* * *

(Pika 4 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë të Drejtësisë

[Shqiptaria.com]